L I G J
Nr. 8915, datë 27.6.2002

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8435, DATË 28.12.1998 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJET NR.8508, DATË 7.7.1999, NR.8519, DATË 30.7.1999, NR.8552, DATË 18.11.1999, NR.8581, DATË 17.2.2000, NR.8651, DATË 28.7.2000, NR.8713, DATË 15.12.2000, NR.8840, DATË 11.12.2001 DHE NR.8858, DATË 14.2.2002

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr.8508, datë 7.7.1999, nr.8519, datë 30.7.1999, nr.8552, datë 18.11.1999, nr.8581, datë 17.2.2000, nr.8651, datë 28.7.2000, nr.8713, datë 15.12.2000, nr.8840, datë 11.12.2001 dhe nr.8858, datë 14.2.2002 bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 shtohen pikat 25, 26 dhe 27 si më poshtë:

"25. Mbitaksa për importet e taksueshme.

26. Taksa mbi konsumin e karburantit.

27. Taksa vjetore nga tatimpaguesit e TVSH-së për ndërtimin e Rrugës Durrës-Kukës.".

Neni 2

Në nenin 6, në pikën "I.Taksat kombëtare", shtohen shkronjat "u", "v" dhe "x" si më poshtë:

"u. Mbitaksa për importet e taksueshme caktohet në masën 1 për qind për të gjitha mallrat e importuara dhe të taksueshme.

v. Taksa mbi konsumin e karburantit caktohet në masën 3 lekë për litër për gazoilin, benzinën dhe benzolin e importuar, si dhe për ata të prodhuar në vend.

x. Taksa vjetore për tatimpaguesit e TVSH-së për ndërtimin e Rrugës Durrës-Kukës caktohet në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në vit, e cila derdhet sipas afateve të përcaktuara për taksat vjetore.".

Neni 3

Në nenin 9, në shkronjën "A. Për taksat kombëtare:", shtohen shkronjat "rr", "s" dhe "sh" si më poshtë:

"rr. Për mbitaksën për importet e taksueshme ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj.

s. Për taksën mbi konsumin e karburantit ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj, për gazoilin, benzinën dhe benzolin e importuar, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për prodhuesit vendas të benzinës, gazoilit dhe benzolit.

sh. Për taksën vjetore nga tatimpaguesit e TVSH-së, për ndërtimin e Rrugës Durrës-Kukës, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj.".

Neni 4

Të ardhurat nga këto taksa të përdoren vetëm për ndërtimin e Rrugës Durrës-Kukës. Fondet e papërdorura brenda vitit mbarten në vitet e ardhshme.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3396, datë 4.7.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani